

COVID Negative Letter

Letra kur jeni COVID negativ

(ALBANIAN)

07/16/20

Ne po ju kontaktojmë me rezultatet e testit tuaj për COVID-19. Testi juaj është negativ për COVID-19.

Rezultatet e Laboratorit

Komponenti	Vlera	Data
COVID19	Nuk Diktohet	07/15/2020

Ndonëse rezultati i testit tuaj është negativ, ekziston mundësia që të ishit shumë herët në infeksion në kohën që ju u testuat dhe mund të testoni pozitiv më vonë, ose mund të ekspozoheni më vonë dhe pastaj të zhvilloni sëmundje.

Nën artikuj:

Me simptoma

- Ju lutemi vazhdoni të izoloni veten në shtëpinë tuaj për 24 orë pasi simptomat tuaja janë larguar pa përdorimin e ilaçeve për uljen e temperatures.

Ekspozimi

- Ju lutemi vazhdoni të izoloni veten në shtëpinë tuaj për 14 ditë që nga kontakti juaj i fundit i njohur me personin pozitiv me COVID-19 dhe vëzhgoni veten për çdo simptomë të COVID-19.

Udhëtime/takime/procedura

- Ata që udhëtojnë jashtë shtetit duhet të izoloohen për 14 ditë

Të gjithë pacientët këshillohen të lajnë duart shpesh, të mbulojnë kollitjet dhe teshtitjet e tyre, të mbajnë një maskë në publik dhe të vazhdojnë distancimin shoqëror, të gjitha këto sipas udhëzimeve të CDC (Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve).

Nëse keni simptoma dhe ato përkeqësohen, ju lutemi kontaktoni mjekun tuaj primar.

Nëse nuk keni një mjek të kujdesit primar, ju inkurajojmë që të telefononi 855-UMASSMD për të filluar kujdesin shëndetsor.

Nëse vazhdoni të mos ndiheni mirë dhe nuk keni një mjek të kujdesit primar ose sigurim shëndetësor, mund të telefononi Care Well Urgent Care në 774-420-2111 ose të shkoni te një Qendër Care Well pranë jush.

Kërkoni kujdes të menjëhershëm mjekësor në Qendrën e Urgjencës nëse shfaqni ndonjë nga këto simptoma: vështirësi në frymëmarrje, dhimbje në gjoks, paaftësi për të ngrënë ose pirë sa

duhet, ose keni të vjella të rënda, diarre ose dobësi. Telefononi përpara se të shkoni në Qendrën e Urgjencës, nëse është e mundur.

Për më shumë informacion nga Departamenti i Shëndetit Publik në Massachusetts, vizitoni faqen e tyre në internet: <https://www.mass.gov/doc/stop-the-spread-of-germs-respiratory-diseases-like-flu-and-covid-19/transferohuni-në-faqen>

CDC (Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve): çfarë duhet të dini:

<https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/downloads/2019-ncov-factsheet.pdf>

Leter kur jeni Covid Positiv

07/16/20

Ne po ju kontaktojmë me rezultatet e testit tuaj për COVID-19. Testi juaj është Pozitiv për COVID-19.

Rezultatet e Laboratorit

Komponenti	Vlera	Data
COVID19	Diktuar	07/15/2020

Nën artikuj:

Rezultat I përsëritur pozitiv

simptomat janë zgjidhur për > 10 ditë; në këtë rast, kriteri që nuk është më ngjitës dhe aprovim plotësohet.

Pozitiv për here të parë

Ne rekomandojmë të merrni masat e mëposhtme për t'ju mbajtur të shëndetshëm dhe të sigurt ju dhe komunitetin tuaj:

1. Ju lutemi vazhdoni të izoloni veten tuaj në shtëpi për 10 ditë që nga fillimi i simptomave tuaja ose 24 orë pasi simptomat tuaja të jenë larguar pa përdorimin e ilaçeve për uljen e temperaturës, cilado qoftë më e gjatë. Qyteti ose Departamenti i Shëndetit Publik (DPH) i qytetit tuaj me siguri do t'ju kontaktojë në lidhje me udhëzimet e vetë-karantinës dhe t'ju tregoj kur të ndërpritni masat paraprake të izolimit në shtëpi. DPH (Departamenti i Shëndetit Publik) do t'ju ndihmojë të vendosni kur mund të ktheheni në punë. Njerëzit e shëndetshëm në shtëpinë tuaj ose të cilët kanë qenë në kontakt të ngushtë me ju do të duhet të vetë-izolohen për 14 ditë dhe të kontaktojnë mjekun e tyre të kujdesit primar (PCP) nëse shfaqin ndonjë simptomë
2. Ju duhet të izoloheni në një dhomë specifike të shtëpisë, dhe të qëndroni larg njerëzve të tjerë në shtëpinë tuaj sa më shumë që të jetë e mundur. Përdorni një banjë të veçantë nëse është e mundur. Evitoni vizitorët. Lani duart shpesh. Mbuloni gojën kur kollitni ose teshtiteni. Evitoni ndarjen e sendeve personale shtëpiake me të tjerët. Pastroni të gjitha sipërfaqet e prekura zakonisht çdo ditë dhe kufizoni kontaktin me kafshët shtëpiake dhe kafshët e tjera
3. Ju lutemi monitoroni simptomat tuaja dhe kontaktoni mjekun e kujdesit primar PCP-në nëse simptomat tuaja përkeqësohen ose keni ndonjë shqetësim tjetër mjekësor
4. Nëse nuk keni mjek të kujdesit primar PCP, ju inkurajojmë të telefononi 855-UMASSMD për të vendosur kujdesin.

5. **Nëse vazhdoni të mos ndiheni mirë dhe nuk keni mjek të caktuar të kujdesit primar ose sigurim shëndetësor**, mund të telefononi Care Well Urgent Care në 774-420-2111 ose të shkoni në një Qendër të Well Care afër jush.
6. Kërkoni kujdes të menjëhershëm mjekësor në Qendrën e Urgjencës (ER) nëse shfaqni ndonjë nga këto simptoma: vështirësi në frymëmarrje, dhimbje në gjoks, paaftësi për të ngrënë ose pirë sa duhet, ose keni të vjella të rënda, diarre ose dobësi. Telefononi përpara se të shkoni në Qendrën e urgjencës, nëse është e mundur.
7. Qëndroni në shtëpi përveçse kur merrni kujdes mjekësor, për të minimizuar kontaktin me të tjerët dhe për të shmangur përhapjen e këtij infeksioni.
8. Vendosni një maskë për fytyrën, nëse duhet patjetër të shkoni në Qendrën e Urgjencës ER ose në zyrën e një mjeku.

Për më shumë informacion nga Departamenti i Shëndetit Publik në Massachusetts, vizitoni faqen e tyre në internet: <https://www.mass.gov/doc/stop-the-spread-of-germs-respiratory-diseases-like-flu-and-covid-19/transferohuni-në-faqen>

CDC (Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve): çfarë duhet të dini:

<https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/downloads/2019-ncov-factsheet.pdf>

Testimi për COVID

Bazuar në gjendjen tuaj, ne po ju dërgojmë për testim për të zbuluar nëse keni coronavirus / COVID-19. Duke filluar nga ky moment, dhe përgjatë kohës deri sa t'ju njoftojmë rezultatet tuaja, ju kërkujmë që të mbroni të tjerët duke ndjekur me kujdes hapat e mëposhtëm. Kjo përfshin mbajtjen e vetvetes larg nga të tjerët kudo që të jetë e mundur dhe përdorimin e këtyre masave të tjera mbrojtëse. Para se të kryhet testi juaj dhe derisa t'ju njoftojmë rezultatet tuaja, ju kërkujmë që të mbani veten larg nga të tjerët.

Ju lutemi ndiqni informacionin më poshtë:

- **Qëndroni në shtëpi përveç kur keni nevojë për kujdes mjekësor:**

- o Ju duhet të qëndroni në shtëpi nga puna, shkolla dhe vendet publike.

- o Mos përdorni transport publik, ndarje udhëtimi me të tjerë ose taksì.

- o Mundohuni të mos shkoni jashtë shtëpisë tuaj, përveç nëse keni nevojë për kujdes

mjekësor.

- **Izoloni veten nga njerëzit e tjerë dhe kafshët në shtëpinë tuaj:**

- o Qëndroni në dhomën tuaj dhe larg njerëzve të tjerë në shtëpinë tuaj.

- o Nëse është e mundur, përdorni një banjë të veçantë.

- o Mos keni vizitorë.

- o Mos keni kontakte me kafshë shtëpiake dhe kafshë të tjera ndërsa jeni të sëmurë me COVID-19, ashtu si do të bëni rreth njerëzve të tjerë.

- **Telefononi përpara se të vizitoni mjekun tuaj:**

- o Nëse keni një takim, telefononi mjekun ose ofruesin e kujdesit tuaj dhe u thoni atyre që keni ose mund të keni COVID-19.

- **Vishni mask fytyre:**

- o Nëse keni nevojë të jeni rreth njerëzve të tjerë brenda ose jashtë shtëpisë, vishni një mask për fytyrën.

- **Mbuloni kollen dhe teshtitjen tuaj:**

- o Mbuloni gojën dhe hundën me një kartpecet kur kolliteni ose teshtiteni.

- **Pastroni duart shpesh:**

o Lani duart shpesh me sapun dhe ujë për të paktën 20 sekonda (këndoni këngën e e urimit për ditëlindjen), ose pastroni duart tuaja me një sanitizues dore me bazë alkooli që përmban 60 deri 95% alkool, duke mbuluar duart tuaja dhe duke i fërkuar ato së bashku, derisa të ndjehen thatë.

o Mos i prekni sytë, hundën dhe gojën me duar të palara. Ata që jetojnë në shtëpinë tuaj gjithashtu duhet të lajnë duart shpesh.

- **Mos i ndani me të tjerë artikujt tuaj personal**
 - o Ju nuk duhet të ndani enët, gotat, filxhanët, pirunë, lugë dhe thika, peshqirë ose shtresat e shtratit me njerëzit e tjerë ose kafshët shtëpiake në shtëpinë tuaj.
 - o Pas përdorimit të këtyre sendeve, ato duhet të lahen me sapun dhe ujë.
- **Pastroni të gjitha zonat me "prekje të shpeshtë" çdo ditë:** Zonat me prekje të shpeshtë përfshijnë sportele, tavolina, doreza, rubineta banjo, tualete, telefona, tastierë, tableta dhe komodinat anash shtratit. Përdorni një solucion pastrimi shtëpiak spruco ose fshirëse të buta të lagura me të dhe ndiqni keshillat në pjesën e pasme të shishes.
- **Shikoni simptomat tuaja:**
 - o Kërkoni kujdes mjekësor menjëherë nëse mendoni se sëmundja juaj po përkeqësohet (p.sh., probleme me frymëmarrjen).
 - o **Përpara** se të merrni kujdes, telefononi mjekun ose ofruesin e kujdesit tuaj dhe u thoni atyre që keni, ose që jeni testuar për COVID -19.
 - o Vendosni një mask në fytyrë para se të hyni në zyrë.
 - o Nëse keni një urgjencë mjekësore dhe keni nevojë të telefononi 911, njoftoni personin që i përgjigjet telefonit që keni, ose po testoheni për COVID-19
 - o Nëse është e mundur, vendosni një mask në fytyrë përpara se të vijë ambulanca.
- **Për njerëzit e tjerë në shtëpinë tuaj**
 - o Duhet të veshin një mask për fytyrën dhe doreza që mund t'i hidhni po të prekin ose kanë kontakt me gjakun tuaj, jashtëqitjen, pështymën, rrjedhjen e hundëve , të vjella dhe urinë
 - o Hidhni maskat e fytyrës dhe dorezat pasi t'i përdorni. Mos i përdorni përsëri
 - o Kur të hiqni maskat e fytyrës dhe dorezat, së pari hiqni dhe hidhni dorezat. Pastaj, pastroni duart tuaja me sapun dhe ujë ose sanitizues duarsh me bazë alkooli.
 - o Pastaj, hiqni dhe hidhni maskën e fytyrës tuaj, dhe pastroni përsëri duart me sapun dhe ujë ose sanitizues duarsh me bazë alkooli.

Rezultatet për testin e kontrollit për COVID-19 aktualisht pritet të marrin disa ditë për t'u rikthyer. Ne do t'ju kontaktojmë nëse testi kthehet pozitiv. Ju lutemi kontaktoni mjekun ose ofruesin e kujdesit tuaj nëse keni ndonjë pyetje.

Nëse testi juaj kthehet POSITIV:

- **Qëndroni në shtëpi derisa t'ju thuhet që mund të dilni:**
 - o Pacientët me COVID-19 të konfirmuar duhet të qëndrojnë nën izolim shtëpie derisa rreziku i kalimit të virusit të tjerët mendohet të jetë i ulët.
- **Ne do të njoftojmë Departamentin e Shëndetit Publik (DPH)**
- **Bisedoni me mjekun ose ofruesin e kujdesit ose zyrtarët e shëndetit public:**
 - o Ndalimi i izolimit në shtëpi bëhet rast pas rasti, në të cilin ne flasim me ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe departamentet shëndetësore shtetërore dhe lokale.
- **Njoftoni punëdhënësin tuaj:** Ata mund të kenë rregulla që lidhen me kohën larg punës dhe kthimit në punë

Nëse testi juaj kthehet **NEGATIV**:

- Vazhdoni izolimin në shtëpi derisa simptomat tuaja të kenë ndalur për të paktën 24 orë. Nëse keni ndonjë pyetje në vazhdim, ju lutemi drejtojuni ofruesit tuaj të kujdesit shëndetësor.

Burimet:

- CDC (Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve) Cfarë të bëni nëse jeni i sëmurë:
<https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/if-you-are-sick/steps-when-sick.html>
- CDC (Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve) Cfarë duhet të dini:
<https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/downloads/2019-ncov-factsheet.pdf>

Kthim në punë për ata që mund të jenë Pozitiv

Atij që Mund t'i Interesojë:

@ EMRI @ @ DitëLindja@ është pacient(e) në Qendrën Shëndetësore të UMass Memorial. @ EMRI @ ose ka raportuar simptoma që ndoshta janë në përputhje me një infeksion të lidhur me koronavirusin ose ka pasur kontakt me dikë që është diagnostikuar me infeksion të koronavirus. Bazuar në udhëzimet e fundit të Qendrës për Kontrollin e Sëmundjeve (CDC), ne kemi këshilluar @ EMRI @ që të qëndroj në shtëpi dhe të vetë-izolohet në këtë kohë. Ajo mund të jetë në gjendje të kthehet në punë në ***.

Kthim në punë për ata që mund të jenë Negativ

Atij që Mund t'i Interesojë:

@ EMRI @ @ DitëLindja @ është pacient në Qendrën Shëndetësore të UMass Memorial. Bazuar në udhëzimet e fundit të CDC (Qendrës për Kontrollin e Sëmundjeve) ne kemi këshilluar që ky person të qëndrojë në shtëpi derisa të jetë asimptomatik (pa simptoma) për 72 orë pa përdorimin e ilaçeve për ulje temperature. Nëse jeni ekspozuar ndaj dikujt që ka testuar pozitiv, duhet të qëndroni në karantinë për 14 ditë. @ EMRI @ është në rregull që të kthehet në punë në *** nëse vazhdojnë të jenë asimptomatik (pa simptoma).

Discontinue:

Covid19triage
Covid19resultnegative
Covid19resultpositive
Covid19resultvm (voicemail)
Covid19homemonitoringvm
Covid19result
Communications list

Eng neg result, Spanish and Portuguese
Eng pos result, Spanish and Portuguese